

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E ARSIMIT
 DHE SPORTIT
 QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

MODEL TESTI I MATURËS SHTETËRORE PROFESIONALE 2025

TEORIA PROFESIONALE E INTEGRUAR

KUALIFIKIMI PROFESIONAL "SHËRBIME MJETESH TRANSPORTI"

Udhëzime për maturantin/kandidatin

Testi përmban gjithsej **60 pikë**.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Testi ka **20 pyetje me zgjedhje (alternativa)** dhe pyetjet e tjera janë me **zhvillim dhe arsytim**.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

| | | | | | | |
|--------|----|----|----|----|----|----|
| Pyetja | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 |
| Pikët | | | | | | |
| Pyetja | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 |
| Pikët | | | | | | |
| Pyetja | 13 | 14 | 15 | 16 | 17 | 18 |
| Pikët | | | | | | |
| Pyetja | 19 | 20 | 21 | 22 | 23 | 24 |
| Pikët | | | | | | |
| Pyetja | 25 | 26 | 27 | 28 | 29 | 30 |
| Pikët | | | | | | |

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

1. Gjendjet e polarizimit të diodës janë: **1 pikë**
- A) e papolarizuar.
 - B) e polarizuar në të drejtë.
 - C) e polarizuar në të kundërt.
 - D) të gjitha të mësipërmet.
2. Në një motor me naftë, kohëzgjatja midis kohës së injektimit dhe kohës së ndezjes quhet: **1 pikë**
- A) periudha e injektimit.
 - B) periudha e ndezjes.
 - C) periudha e avancës.
 - D) periudha e vonesës.
3. Termi cilindër kryesor lidhet me: **1 pikë**
- A) sistemin e frenimit.
 - B) sistemin e lubrifikimit.
 - C) cilindrin ftohës.
 - D) motorin.
4. Nëse dy ingranazhe kanë raport ingranimi 4:1 dhe marshi më i vogël ka 12 dhëmbë, marshi i madh do të ketë: **1 pikë**
- A) 12 dhëmbë.
 - B) 24 dhëmbë.
 - C) 36 dhëmbë.
 - D) 48 dhëmbë.
5. Nga katër gomat në një makinë, ajo që konsumohet më shumë është: **1 pikë**
- A) goma e përparme djathtas.
 - B) goma e pasme djathtas.
 - C) goma përparme e majtë.
 - D) goma e pasme e majtë.
6. Zhurmat e friksionit janë zakonisht më të dëgjueshme kur motori është: **1 pikë**
- A) duke u nisur.
 - B) duke u ngadalësuar.
 - C) neutral.
 - D) duke u përshpejtuar.
7. Pjesa e pompës që rrotullohet dhe shkakton qarkullimin e ujit ndërmjet radiatorit dhe motorit quhet: **1 pikë**
- A) helikë.
 - B) ventilator.
 - C) valvul.
 - D) termostat.
8. Funkzioni i sensorëve lambda në konvertuesin katalitik është: **1 pikë**
- A) të mbajë raportin e ajrit të tepërt brenda një intervali.
 - B) të mbajë shpejtësinë e rrjedhës së ajrit konstant.
 - C) të mbajë presionin e shkarkimit konstant.
 - D) të mbajë konstante temperaturën e shkarkimit.

- 9.** Valvula e presionit në sistemin e vajosjes: **1 pikë**
- A) rrit presionin në sistem.
 - B) hapet nga presioni i lartë në sistem.
 - C) hapet nga presioni i ulët në sistem.
 - D) filtron vajin në sistem.
- 10.** Sensori i presionit absolut në kolektor (MAP) mat vlerën e depresionit në : **1 pikë**
- A) kolektorin e thithjes.
 - B) kolektorin e shkarkimit.
 - C) bllokun e cilindrave.
 - D) depresorin e frenave.
- 11.** Hollimi i vajit lubrifikues shkaktohet nga: **1 pikë**
- A) karburantet.
 - B) uji.
 - C) mbetjet e ngurta të djegies.
 - D) ndotës të ngurtë si pluhuri, etj.
- 12.** Raporti i karburantit në ajër pritët të jetë më i larti në: **1 pikë**
- A) motor diezel me dy kohë.
 - B) motor diezel me katër kohë.
 - C) motor benzine me dy kohë.
 - D) motor benzine me katër kohë.
- 13.** Tubat e radiatorit janë bërë përgjithësisht prej: **1 pikë**
- A) plastike.
 - B) gize.
 - C) bronzi.
 - D) çeliku.
- 14.** Rrjedhja e gazit të shkarkimit në sistemin e ftohjes ndodh për shkak të defektit në: **1 pikë**
- A) termostat.
 - B) radiator.
 - C) pompën e ujit.
 - D) guarnicion në kokën e cilindrit.
- 15.** Procesi i djegies në një motor nafte është: **1 pikë**
- A) procesi i presionit të vazhdueshëm.
 - B) procesi izotermik.
 - C) procesi me volum konstant.
 - D) procesi adiabatik.
- 16.** Kur friksioni është i kyçur, presioni i sustës shtrëngon diskun e friksionit me: **1 pikë**
- A) volantit.
 - B) diferencialin.
 - C) transmisionin.
 - D) pedalin e frenit.

17. Sensori i goditjeve është prej materiali: 1 pikë

- A) çelik.
- B) gizë.
- C) alumin.
- D) piezoelektrik.

18. Sistemet e diagnostikimit në bord: 1 pikë

- A) gjithmonë gjejnë kodet e problemeve.
- B) ruajnë kodet e problemeve.
- C) nuk informojnë sensorët për problemin e motorit.
- D) informojnë sensorët për problemin e motorit.

19. Cila veçori është disavantazh i motorit me naftë, krahasuar me atë me benzinë? 1 pikë

- A) Rendimenti më i ulët.
- B) Nevoja për një sistem ndezës.
- C) Konsum më të madh të lëndës djegëse.
- D) Fuqi të ulët të motorit.

20. Sinkronizatorët janë krijuar për të parandaluar përplasjen e marsheve kur kalojnë nga: 1 pikë

- A) i pari tek i dyti.
- B) i dyti tek marshi me i lartë.
- C) i pari tek i kundërti (reverse).
- D) të gjitha të mësipërmet.

21. Listoni 4(katër) shkaqe pse ABS (antilock brake system) nuk funksionon në automjet. 4 pikë

- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____
- 4) _____


22. Në secilin nga pohimet e mëposhtme, rrethoni përgjigjen e saktë. 4 pikë

- 1) Sistemi i rregullimit të ndriçimit të përparmë përdor ndriçues dinamikë. PO JO
- 2) Siguria pasive krijohet nga tërësia e karakteristikave teknike, që ndihmojnë aktivisht për sigurinë e kontrollit të mjetit në lëvizje. PO JO
- 3) Oshiloskopi përdoret për matjen e madhësive jo elektrike pa i konvertuar në sinjal elektrik. PO JO
- 4) Filtri i grimcave (pm) DPF i vendosur në makinat me naftë ruan brenda trupit të tij vetëm grimcat pm. PO JO

23. Në secilin nga pohimet e mëposhtme, rrethoni përgjigjen e saktë. 4 pikë

- | | | |
|---|----|----|
| 1) Një kandlele përdoret për të ndezur karburantin në një motor diesel. | PO | JO |
| 2) Ekzistojnë dy lloje të sistemeve të varjes elektronike : adaptive dhe aktive. | PO | JO |
| 3) Vendndodhja e termostatit nuk përcaktohet nga lloji dhe modeli i motorit. | PO | JO |
| 4) Në rastin kur një pështjellë e rotorit të motorinos e lidhur në seri është e këputur, rezistenca e saj Ohmike është infinit. | PO | JO |

24. Në skemën e motorit me injeksion elektronik, për pohimet e mëposhtme, rrethoni përgjigjen e saktë. 4 pikë



- | | | |
|---|----|----|
| 1) Elementi «4» është pjesë e Sistemit të injektimit. | PO | JO |
| 2) Elementi «2» mund të ushtrojë presion në kolektorin e shkarkimit. | PO | JO |
| 3) Elementi «3» kryen pastrimin (gjenerimin) kur motori është i ftohtë. | PO | JO |
| 4) Elementi «6» është sensori i temperaturës së motorit. | PO | JO |

25. Në figurën e mësipërme, emërtoni elementet. 4 pikë

- 1) Elementi 1: _____
- 2) Elementi 5: _____
- 3) Elementi 7: _____
- 4) Elementi 11: _____

26. Në secilin nga pohimet e mëposhtme për sistemin e ftohjes, vendosni e vërtetë (V) ose e gabuar (G). **4 pikë**

- 1) Kur termostati është i hapur, temperatura e motorit bie nën normalen. ____
- 2) Kur termostati është i mbyllur, motori nuk mund të mbinxehet. ____
- 3) Puna e një termostati është të mbajë temperaturën e motorit mbi temperaturën minimale të operimit 75°C. ____
- 4) Makinat moderne përdorin një valvul të kontrolluar elektronikisht të quajtur "valvula e kontrollit ftohës" në vend të një termostati. ____


27. Në kodin e gabimit **C 0310**, vendosni e vërtetë (V) ose e gabuar (G). **4 pikë**

- 1) Shifra e parë C, tregon që kemi një problem në motor. ____
- 2) Shifra e dytë tregon organizatën përgjegjëse për përcaktimin e kodit. ____
- 3) Shifra e tretë përfaqëson një funksion të veçantë të automjetit. ____
- 4) Shifra e katërt dhe shifra e pestë janë veçanërisht të lidhura me defektin. ____

28. Listoni 4 (katër) komponentë të sistemit të ftohjes në motor. **4 pikë**

- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____
- 4) _____

29. Në figurën e mëposhtme, emërtoni elementet:. **4 pikë**



- 1) Elementi 4: _____
- 2) Elementi 5: _____
- 3) Elementi 3: _____
- 4) Elementi 2: _____

30.Listoni 4(katër) arsye pse treguesi i temperaturës në makinë nuk është i qëndrueshëm.

4 pikë

- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____
- 4) _____